



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 60-të, të mbajtur më 26 tetor 2018, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit institucional e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM) për periudhën 01.02.2018 – 30.09.2019.
- II. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM) për periudhën 01.02.2018 – 30.09.2019.
 - Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë, (BA Profesional, 210 ECTS);
 - Shitje dhe Marketing Ndërkombëtar, (BA Profesional, 210 ECTS);
 - Menaxhimi i Shërbimeve Publike, (BA Profesional, 210 ECTS);
 - Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë, (Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KKK, 120 ECTS);
 - Marketing dhe Menaxhment, (Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KKK, 120 ECTS), dhe
 - Administratë Publike (Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KKK, 120 ECTS).
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 26 Tetor 2018 mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit institucional dhe të programeve të studimit për Kolegjit Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin I dhe II të këtij vendimi. Duke pasur parasysh se dinamika e AKA-së për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë është ndërprerë për 7 muaj dhe se procesi i vlerësimit të jashtëm nuk është organizuar, vizita me ekspertë ndërkombëtarë nuk është realizuar sipas afateve të parapara nga AKA, dhe rrjedhimisht rrezikohet vonimi i regjistrimit të studentëve të rinj në këto programe të studimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Marrë parasysh rrethanat e krijuara për arsye të mos funksionalizimit të KSHC-së të AKA-së për 7 muaj, për situatën e jashtëzakonshme të krijuar për IAL-të dhe procesin e vlerësimit dhe akreditimit, duke pasur parasysh ndeshjen e afateve ligjore për sa i përket procesit të aplikimit për ri/akreditim si dhe procesin e deklarimit të stafit akademik në përputhje me UA për Akreditim Nr. 9/2017, duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037- datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, i cili përcakton se “Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Ky rishikim nga ana e ekspertëve do të përfshijë një inspektim të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve. Riakreditimin e një institucioni apo të një ose më shumë programeve të tij mund ta kërkojnë bordi i AKA-së ose Ministria brenda një periudhe më të shkurtër se pesë vjet.”, si dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM), me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I, II, të këtij vendimi. Në të kundërtën KSHC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërin nga mbledhjet e radhës së KSHC-së të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriterëve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.15/2018, datë 28.09.2018.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegjit Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

